## AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË CSPFIN S.R.L. SHPK

### THEMELIMI

**NENI 1 - ORTAKËT THEMELUES**

1.1 Shoqëria **CSPFIN S.R.L.** SHPK themelohet nga Ortaku i Vetëm:

**Z. Cosimo Savio Pipitone**, shtetas italian, lindur më 07.09.1963 në Marsala (TP) dhe banues në Via Mazara nr. 210/C, Marsala, Itali, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. CA53279EE, me zotësi të plotë për të vepruar;

I cili me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë krijon shoqërinë si vijon.

### EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

**NENI 2 - EMËRTIMI**

2.1 Emërtimi i shoqërisë është **CSPFIN S.R.L.** SHPK (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

**NENI 3 - FORMA LIGJORE**

3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**NENI 4 - BAZA LIGJORE**

4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Akt Themelimi dhe Statut, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore në fuqi.

4.2 Për sa nuk është parashikuar ne ketë Statut, do të aplikohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

4.3 Çdo mosmarrëveshje që mund të lind në lidhje me zbatimin dhe/ose interpretimin e këtij Statuti, do të zgjidhet nga gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**NENI 5 - PERSONALITETI JURIDIK. KOHËZGJATJA**

5.1 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Tiranë, Shqipëri.

5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është i pakufizuar.

**NENI 6 - SELIA**

6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga Abdyl Frasheri, Ndërtesa 8, Hyrja 7, Ap. 25, 1019 Tiranë.

6.2 Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.

## ATTO COSTITUTIVO E STATUTO DELLA SOCIETA CSPFIN S.R.L. SHPK

### LA COSTITUZIONE

**ARTICOLO 1 - I SOCI COSTITUENTI**

1.1 La società **CSPFIN S.R.L.** SHPK è costituita dal Socio Unico:

**Sig. Cosimo Savio Pipitone**, cittadino italiano, nato il 07.09.1963 a Marsala (TP) residente a Via Mazara nr. 210/C, Marsala, Italia, titolare della Carta d'Identita No. CA53279EE, con piena capacitá di agire;

il quale con libera e piena volontá costituisce la società come segue.

### DENOMINAZIONE, SEDE E FORMA LEGALE

**ARTICOLO 2 – DENOMINAZIONE SOCIALE**

2.1 Il nome della società è **CSPFIN S.R.L.** SHPK (in seguito denominata "La società")

**ARTICOLO 3 – FORMA LEGALE DELLA SOCIETA**

3.1 La società ha la forma di Società a responsabilità limitata ed è stata costituita secondo le previsioni della legislazione commerciale albanese.

3.2 La società può trasformare la sua forma legale nel rispetto della legislazione albanese in vigore.

**ARTICOLO 4 – LA LEGGE APPLICABILE**

4.1 La società eserciterà la sua attività nel rispetto di questo Statuto, dell'Atto Costitutivo e della legge commerciale e altre leggi in vigore.

4.2 Per quanto previsto da questo Statuto, verranno applicate le disposizioni della legge no. 9901, del 14.04.2008, "Per gli imprenditori e le imprese", modificata.

4.3 Ogni controversia che può sorgere dalla esecuzione e/o interpretazione del presente Statuto, verrà risolto dal Tribunale distrettuale di Tirana.

**ARTICOLO 5 – PERSONALITA GIURIDICA. DURATA DELLA SOCIETA**

5.1 L'attività della società avrà inizio con la sua iscrizione presso il Centro Nazionale delle Imprese a Tirana, Albania.

5.2 La durata della Società è a tempo indeterminato.

**ARTICOLO 6 – LA SEDE**

6.1 La società ha sede nell'indirizzo: Rruga Abdyl Frasheri, Ndërtesa 8, Hyrja 7, Ap. 25, 1019 Tiranë.

6.2 La società può istituire sedi secondarie, filiali od altre unità locali rappresentative sia entro il territorio dello stato albanese, sia all'estero.

PIPITONE COSIMO SAVIO

| | |
|---|---|
| 6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera Shqiptare ose te huaja që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen. | 6.3 La società può prendere parte, acquisendone quote, di un'altra società esistente, oppure che verranno costituite in futuro sia entro il territorio dello stato albanese, sia all'estero. |
| **NENI 7 - EMBLEMA. VULA** | **ARTICOLO 7 – LOGO E TIMBRO** |
| 7.1 Shoqëria do të ketë emblemën dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë. | 7.1 La società avrà un suo logo ed il suo timbro. Competenti ad usare il timbro della società saranno i suoi amministratori. |
| 7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar. | 7.2 La forma e le misure del timbro saranno definite in accordo con la normativa albanese in vigore. |
| 7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përmbajnë emblemën dhe vulën e saj. | 7.3 Tutti i documenti emessi della società dovranno recare il logo ed il timbro della società. |
| **NENI 8 - OBJEKTI** | **ARTICOLO 8 – OGGETTO SOCIALE** |
| 8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:<br><br>Aktivitete të ndërmjetësimit të kredisë dhe këshillimit në dhënien e huave për ndërmarrjet private (pa përfshirë kreditë konsumatore), transaksione financiare instrumentale, konsulencë tregtare, ndërmjetësimi tregtar dhe promovim financiar. | 8.1 La società ha per oggetto:<br><br>Attività di mediazione creditizia e di consulenza nella concessione di finanziamenti ad aziende private (no credito al consumo). Operazioni finanziarie "strumentali". Consulenza commerciale, intermediazione commerciale. |
| 8.2 Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër i cili është në përputhje me Ligjet e Republikës së Shqipërisë. | 8.2 La società può esercitare qualsiasi atra attività in conformità con le leggi della Repubblica d'Albania. |
| **NENI 9 – KAPITALI THEMELTAR** | **ARTICOLO 9 – IL CAPITALE SOCIALE** |
| 9.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1,000 (njëmijë) EURO. | 9.1 Il capitale sociale è di 1,000 (mille) EURO. |
| 9.2 Kapitali themeltar përbehet nga 1 (nje) kuote me vlerë nominale 1,000 (njëmijë) EURO. | 9.2 Il capitale è diviso in 1 (una) quota con valore nominale di 1,000 (mille) EURO. |
| 9.3 Kapitali zoterohet teresisht nga Ortaku i Vetem. | 9.3 Il capitale è interamente posseduto dal Socio Unico. |
| 9.4 Përgjegjësia e Ortakut shtrihet deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin e Shoqërisë. | 9.4 La responsabilità del Socio si estende fino al valore del suo contributo riguardo al capitale sociale. |
| **NENI 10 - TRANSFERIMI I KUOTAVE. KUFIZIMET** | **ARTICOLO 10 – IL TRASFERIMENTO DELLE QUOTE. LE LIMITAZIONI** |
| 10.1 Kuota e kapitalit është e transferueshme dhe mund të transferohet në çdo moment sipas kushteve dhe afateve të parashikuara nga ligji shqiptar. | 10.1 La quota del capitale sociale è trasferibile e può essere trasferita in conformità con disposizioni di legge in vigore. |
| 10.2 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi pjesët e kapitalit në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Asamblesë së Ortakëve. | 10.2 Le quote del capitale sociale possono essere gravate da diritti reali di garanzia a favore dei terzi solo previo assenso dell'Assemblea dei Soci. |
| **ORGANET E SHOQËRISË** | **GLI ORGANI SOCIETARI** |
| **NENI 11 - VENDIMET E ASAMBLESË SË ORTAKËVE** | **ARTICOLO 11– LE DECISIONI DELL'ASSEMBLEA DEI SOCI** |
| 11.1 Asambleja e Ortakëve në përputhje me legjislacionin shqiptar, mund të vendosë, por pa u kufizuar në to, vendimet me poshtë:<br>- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre nga administratori ose administratoret, përfshi raportet financiare;<br>- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;<br>- miratimin e shkrirjes/bashkimit me shoqëri të tjera;<br>- ndryshimin e statutit të shoqërisë;<br>- ndryshimin e selisë dhe të emërtimit të shoqërisë; | 11.1 L'assemblea dei Soci secondo le disposizione della legislazione albanese, puo deliberare a titolo esemplificativo e non esaustivo, sulle seguenti materie:<br>- approva le politiche commerciali della società e sorveglia la loro esecuzione da parte dell'amministratore o dei amministratori, compreso i rapporti finanziari;<br>- aumento e riduzione del capitale societario<br>- scioglimento/fusione con altre società; |

PIPITONE COSIMO SAVIO

- emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar, në qoftë se është e nevojshme;
- rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
- shitjen ose transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar palëve të treta;
- ristrukturimin dhe prishjen shoqërisë;
- emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë;
- miratimin e pasqyrave financiare të shoqërisë dhe raportit te administatorit(eve);
- vendimin për shpërndarjen e fitimit dhe mbulimin e humbjeve;
- transformimin e shoqërisë në forma të tjera;
- dhe çdo lëndë tjetër të parashikuar nga Statuti ose nga ligji.

**NENI 12 - ADMINISTRIMI**

12.1 Administrimi i shoqërisë do te kryhet nga një ose më shumë administratorë që emërohen me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Në rast se Shoqëria do të administrohet nga më shumë se një administrator, atëherë Administratorët mund t'i ushtrojnë kompetencat bashkërisht ose veçmas sikurse do të përcaktohet në vendimin përkatës të Asamblesë së Ortakëve.

12.2 Administratori i parë i shoqërisë është:

**Z. Cosimo Savio Pipitone**, shtetas italian, lindur më 07.09.1963 në Marsala (TP) dhe banues në Via Mazara nr. 210/C, Marsala, Itali, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. CA53279EE.

12.3 Administratorëve u jepen te gjitha kompetencat e përcaktuara nga legjislacioni i Republikës se Shqipërisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në to. Administratoret janë përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:
- drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
- përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose me përfaqësim;
- hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
- përgatitjen e dokumenteve në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zotëron;
- të lidhë kontrata për dhe në emër të shoqërisë me palë të treta, të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm për mbarëvajtjen e aktivitetit të shoqërisë;
- të përfaqësojë shoqërinë përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankës së Shqipërisë si dhe të kryej çdo transaksion bankar në emër të shoqërisë;
- të ndërmarrë çdo veprimtari tjetër, ose biznes, ose aktivitet i cili konsiderohet i nevojshëm për administrimin efikas të Shoqërisë në Shqipëri.

12.4 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për pesë vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

- modifica dello statuto della società;
- modifica della sede legale e denominazione societaria;
- nomina gli esperti contabili autorizzati se necessario;
- vendita o trasferimento delle quote del capitale sociale a altre parti;
- ristrutturazione e scioglimento della società;
- nomina e revoca dell'amministratore o degli amministratori della società;
- approvazione dell'bilancio della società e del rapporto dell'amministratore/degli amministratori;
- decisione sulla distribuzione dell'utile e la copertura delle perdite;
- trasformazione della forma legale della società;
- altre materie previste dallo Statuto o dalla legge.

**ARTICOLO 12 – L'AMMINISTRAZIONE**

12.1 La società è amministrata da un amministratore o da più amministratori nominati con delibera dell'Assemblea dei Soci.

In caso la società viene amministrata da più di un amministratore, allora l'amministratore deve esercitare le competenze congiuntamente o separatamente come previsto dalla delibera dell'Assemblea dei Soci.

12.2 Il primo amministratore della società è:

**Sig. Cosimo Savio Pipitone**, cittadino italiano, nato il 07.09.1963 a Marsala (TP) residente a Via Mazara nr. 210/C, Marsala, Italia, titolare della Carta d'Identita No. CA53279EE.

12.3 Agli amministratori vengono conferite tutte le competenze previste dalla legislazione della Repubblica d'Albania, compreso a titolo esemplificativo e non esaustivo, gli amministratori hanno i seguenti diritti e doveri:

- amministra l'attività giornaliera della società;
- rappresenta la società nei confronti dei terzi, di persona o come mandante;
- prepara e amministra la contabilità della società;
- prepara la documentazione relativa alle sue competenze, in nome della società;
- stipula e sottoscrive, in nome e per conto della società, i contratti con i terzi, assume e licenzia i lavoratori/dipendenti o altro staff necessario per la buona amministrazione della società;

- rappresenta la società nei confronti delle banche di secondo livello in Albania e della Banca d'Albania, nonché esegue in nome della società le transazioni bancarie;
- svolge qualsiasi altra mansione necessaria o d'impresa, o attività per la realizzazione degli obiettivi della società;

12.4 L'amministratore rimane in carica per cinque anni con diritto di rinnovo oppure fino alla revoca del mandato da parte dell'Assemblea dei Soci.

PIPITONE COSIMO SAVIO

| | |
|---|---|
| 12.5 Administratori i Shoqërisë mund t'i transferojë çdo personi apo grupi personash të gjitha apo një pjesë të kompetencave të tij sipas këtij Statuti dhe me kushtet që ai konsideron si të arsyeshme dhe në çdo kohë mund të anullojë ketë transferim kompetencash. | 12.5 L'amministratore della società può trasferire a ogni persona o gruppo di persone tutte o pure una parte delle sue competenze secondo questo Statuto e secondo le condizioni che considera ragionevoli e in ogni momento che ritiene opportuno può annullare questo trasferimento di competenze. |
| **NENI 13 - VITI FINANCIAR** | **ARTICOLO 13 – ESERCIZIO SOCIALE** |
| 13.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti. | 13.1 L'esercizio sociale corrisponde a l'anno del calendario, inizia il 1° gennaio e si chiude il 31 Dicembre di ogni anno. |
| 13.2 Përjashtimisht, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti. | 13.2 Eccezionalmente, il primo esercizio sociale inizia dal giorno dell'iscrizione della società presso il Centro Nazionale di Registrazione e si chiude il 31 Dicembre dello stesso anno. |
| **NENI 14 - BILANCI. KONTABILITETI.** | **ARTICOLO 14 – BILANCIO. CONTABILITA.** |
| 14.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore dhe Qendrës Kombëtare të Regjistrimit deri në fund të muajit Mars to cdo viti pasardhës. | 14.1 Il bilancio della società deve essere approvato dall'Assemblea dei Soci e viene presentato presso gli organi tributari e il Centro Nazionale di Registrazione entro la fine del mese di marzo dell'anno successivo. |
| 14.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave te legjislacionit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit. | 14.2 La contabilità si esprime in lingua e moneta albanese secondo le previsioni della legge in vigore. In casi particolari, la società può operare anche in conto corrente in moneta estera, convertendo poi la somma entro l'anno. |
| 14.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve. | 14.3 La società può ricevere finanziamenti da parte delle istituzioni finanziare operanti in Albania oppure all'estero. A questo scopo la società può concedere in pegno od iscrivere un'ipoteca sopra il suo patrimonio immobiliare solo tramite delibera dell'Assemblea dei Soci. |
| **NENI 15 - TE ARDHURAT, DIVIDENDI** | **ARTICOLO 15 – GLI UTILI. I DIVIDENTI** |
| 15.1 Shoqëria mund të krijojë fonde rezerve për realizimin e qëllimeve të aktivitetit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". | 15.1 La società costituirà un fondo di riserva per la realizzazione dei suoi fini secondo le previsioni della Legge Nr. 9901, dell'14.4.2008 "Per gli imprenditori e le imprese". |
| 15.2 Fitimet që do të rezultojnë në fund të mbylljes së çdo viti ushtrimor, pas pagimit të tatimeve, mund të ndahen nga Asambleja e Ortakëve. | 15.2 Gli utili realizzati alla fine di ciascun anno d'esercizio, dopo aver versato l'imposta dovuta, possono essere distribuiti dall'Assemblea dei Soci. |
| 15.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe çdo ortak do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. | 15.3 La società risponde delle sue perdite fino al limite del suo capitale sociale e ciascun socio risponde delle perdite fino al limite del suo contributo nel capitale sociale. |
| **NENI 16 - LIKUIDIMI** | **ARTICOLO 16 – LIQUIDAZIONE** |
| 16.1 Likuidimi i Shoqërisë si dhe emërimi i likuidatorit(eve) bëhet ne përputhje me ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 ""Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe çdo ligj tjetër të zbatueshëm. | 16.1 Lo scioglimento della società e la nomina del/dei liquidatore/liquidatori è decisa secondo le previsioni della Legge Nr. 9901, dell'14.4.2008 "Per gli imprenditori e le imprese", modificato e ogni altra legge applicabile. |
| **NENI 17 - MOSMARRËVESHJET** | **ARTICOLO 17 – LE CONTROVERSIE** |
| 17.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare. | 17.1 Le controversie che possono nascere tra la società ed i terzi, se non risolte attraverso il compromesso, verranno sottoposte alla giurisdizione del tribunale albanese competente. |

PIPITONE COSIMO SAVIO

**NENI 18 - KLAUZOLË MBYLLËSE**

18.1 Ky Statut hartohet në 3 (tre) ekzemplare me fuqi të njëjtë ligjore.

**ORTAKU I VETEM**

Cosimo Savio Pipitone

Date 22/01/2021

**ARTICOLO 18 – CLAUSOLA DI CHIUSURA**

18.1 Questo statuto è redatto in tre (3) copie con lo stesso valore giuridico.

**IL SOCIO UNICO**

Cosimo Savio Pipitone

Date 22/01/2021